

PAMFLET INFORMATIV

PËR

PRINDËRIT E FËMIJËVE TË CILËT KËRKOJNË AZIL DHE
REFUGJATËVE SHKOLLARËVE

TË ARSIMIMIT FILLORË

Përgatiti

AGJENCIONI PËR PRANIM DHE INTEGRIM

Në bashkëpunim me
Integrate Ireland Language and Training

Gusht, 2001

Pamflet informativ
për
prindërit e fëmijëve të cilët kërkojnë azil, dhe refugjatëve
shkollarëve të arsimit fillorë

Hyrje

Në Irlandë vijnë të jetojnë njerëz nga shumë popuj dhe kultura. Secili vend ka sistem arsimor të veçant i cili mund të dalloj nga sistemi arsimor irlandez. Ekzistimi i dallimeve nuk do të thotë se njëri sistem është më i mirë ose më i keq nga tjetri-vetëm është i ndryshëm. Ky pamflet është i përgatitur në bashkëpunim me prindërit, drejtorët dhe mësuesit. Qëllimi i pamfletit është që tu përgjigjet disa pyetjeve të zakonshme të cilat i parashtrojnë prindërit për të cilët sistemi i arsimit në Irlandë është risi. Pamflet i njejtë ekziston edhe për prindërit e fëmijëve në shkollën fillore.

A. Arsimiti primar- Përcaktimi nacional

1. A është patjetër që fëmija im të shkoj në shkollë?

Po. Në Irlandë **TË GJITHË** fëmijët pa marrë para syshë se janë apo jo të nacionalitetit Irlandez kanë të drejtë për arsimim post primar dhe primar pa pages. Në Irlandë të gjithë fëmijët prej 6 deri në 15 vjet janë të detyruar **ME LIGJ** të shkojnë në shkollë. Fëmija juaj **PATJETËR** të shkoj në shkollë çdo ditë. (Shiqoni xhithashtu pyetjen 31)

2. Çka mendohet me arsimim fillor dhe post-fillorë?

Në përgjithësi, fëmijët të cilët kanë më pak 4 vjet përafërsisht deri në 12 vjet më 1. shtator të vitit akademik, fillojnë në shkollë fillore, kurse fëmijët përafërsisht prej 12 deri më 18 vjet fillojnë shkollën post-fillore.

3. Kush është përgjegjës për arsimimin formal të fëmijëve në Irlandë?

Ministria e arsimit dhe shkencës (The Department of Education and Science) mban përgjegjësi për udhëheqjen e arsimit publik – duke përfshirë arsimimin post-fillor në nivel nacional.

4. Në cilën shkollë do të shkoj vajza/djali im?

Në vend egzistojnë më shumë se 3100 shkolla fillore. Në disa qendra më të mëdhaja private vajza ose djali juaj mund të vendoset në shkollën private. Nëse nuk është ky rast, atëherë udhëheqësi i qendrës private do t'ua jep emrin e shkollës lokale. Gjithashtu, regjistrimi i shkollës lokale do të jetë i pranishëm në paketin informativ në rrethinën në të cilën gjendet qendra pranuese.

Nëse doni që vajzën/djalin tuaj ta regjistroni në shkollë ju lutemi që me anë të telefonit të kontaktoni me drejtorin e shkollës, me të të caktoni takim. **MOS SHKONI NË SHKOLLË PËR HERË TË PARË PA MOS U PARAQITUR.** Nëse e ndjeni se anglishtja juaj nuk është e mirë që të mund të bisedoni me drejtorin, me vete mund të merni shok i cili din të flas anglisht ashtu që të mundë t'iu ndihmoj në bisedë .

Në takimin e parë me drejtorin mund ti luteni që ta regjistroj fëmijën tuaj. Nëse shkolla është e mbushur atëherë ndoshta nuk do të ketë mundësi ta regjistroj fëmijën tuaj. Do t'iu rekomandoj shkollë tjetër në atë rajon.

5. Cilat lloje të pyetjeve do t'ua parashtrij drejtori në takimin e parë?

Nëse djali/vajza juaj është regjistruar në shkollë drejtori do të don të di :

emrin, moshën dhe nacionalitetin e djalit/vajzës tuaj

çfar arsimimi ka ndjekur vajza/djali juaj deri tani

çfar interesi të veçantë ka djali/vajza juaj si p.sh muzik, art, sport etj

A ka ai/ajo ndonjë problem shëndetsorë për të cilin shkolla duhet ta di nëse ai/ajo alivanoset në kohën kur është në shkollë p.sh astma/epilepsia

Emri juaj, adresa dhe numri i telefonit në të cilin mund të kontaktojnë me ju p.sh nëse djali/vajza juaj sëmuret në kohën kur gjendet në shkollë

A doni që djali/vajza juaj të ndjek arsimim religjioz ose të merr pjesë në ritet religjioze.

Drejtori mund të don të di emrin e puntorit tuaj social ose për mirëqenijen e bashkësis. Secilin informacion që e ofroni do të jetë i ruajtur në besim të plotë.

6. A egzistojnë lloje të ndryshme të shkollave?

Po. Të gjithë shkollat fillore bazohen në etikë fetare të caktuar, p.sh : Rimokatolike, Shkolla e Kishës Irlandeze, Muslimane, kurse në shkollat "Arsimim të bashku" bazë është etika multi religjioze. Në shumicën e shkollave gradualisht mësohet në gjuhën angleze. Kurse në disa shkolla gradualisht mësohet në gjuhën irlandeze-gjuhën amtare të irlandës. Shkollat me pole të ndara i mësojnë djemt dhe vajzat veçmas. Shkollat e tjera djemt dhe vajzat i mësojnë bashkë.

7. A mund të ma sqaroni arsimimin fillorë?

Fëmijët mund të fillojnë në shkollë në shtator pas ditëlindjes së katërt të tyre, të tjerët presin deri sa ti mbushin pes vjet. Shkollat e ndryshme kanë rregulla të ndryshme për regjistrimin e fëmijëve në klasën e fëmijëve junior.

Arsimimi fillorë zgjatë 8 vite (shiqoni tabelën posht). Fëmijët kalojnë nga një vjet në çdo klasë. Ndonjëherë mësuesi mund të rekomandoj që nxënësi ta përsërit klasën.

Përafërsisht mosha	Viti	Emri i klasës
4 – 5 vjet	1	Fëmijorë juniorik
5 - 6 vjet	2	Fëmijorë seniorik
6 – 7 vjet	3	Klasa e parë
7 - 8 vjet	4	Klasa e dytë
8 - 9 vjet	5	Klasa e tretë
9 – 10 vjet	6	Klasa e katërt
10 - 11 vjet	7	Klasa e pestë
11- 12 vjet	8	Klasa e gjashtë

Në secilin vit shkollorë egzistojnë tre tremujore.

- fillimi i shtatorit deri në mes të dhjetorit (Krishtlindje)
- fillimi i janarit deri në mesin e marsit/prillit(Pashkë)
- prej Pashkut zakonisht deri në fund të qershorit çdo vit

Në mes të secilit tremujorë mund të egzistojnë festa të shkurta të cilat quhen gjysëm tremujorë (half-term ose mid-term) dhe mund të zgjasin prej disa ditësh deri në një javë.

8. Çka nëse shkolla mbyllet gjatë vitit?

Secila shkollë si zakonisht paraqet renditjen e ditës kurë do të mbyllet shkolla për shkak të festës, personelit të mbrendshëm ose për shkaqe tjera. Prindërve u jepet kopije e këtyre renditjeve ditore. Nëse shkolla papritmas duhet të mbyllet për një ditë ose gjysëm dite ajo do ti thuhet djalit ose vajzës suaj.

Shembull i lajmërimit: Shkolla do të jetë e mbyllur të mërkurën, 13 tetor për...

9. A mund të ma sqaroni ditën shkollorë?

Dita e shkollës zgjat 5 orë e 40 minuta mësimi zakonisht fillon mes 8.45 dhe 9.30 shkollat janë të hapura prej të hënën deri të premten. Në ditët shkollorë normalisht ekziston pushimi paraditorë dhe pushim për drekë. Me rëndësi është që fëmijëve tuaj tu siguron ushqim dhe pije për këto dy pushime. Kontrolloni te drejtori i shkollës a është i ndaluar ushqimi si çips, çokolladë etj. Mund të ndodhë që gjithashtu të jenë të ndaluara pijet me shishe dhe pijet e gazuara. Nëse nuk jeni të sigurt pyetni te drejtori dhe te kujdestari i klasës.

Nëse jetoni në qendrën për vendosje, ju lutemi të mëreni vesht me udhëheqësin për haje/pije të nevojshme për të dy pushimet shkollorë.

Fëmijët më të vegjël ditën e vet të shkollës mund ta mbarojnë një orë më parë se fëmijët më të vjetër.

Për fëmijët më të vjetër mund të organizohen lojra sportive ose aktivitete tjera si zakonisht nga ana e mësuesit.

10. Cila është struktura e personelit në mbrendi të shkollës?

Drejtori i cili mund të jetë mashkull apo femër ka përgjegjësi më të madhe për udhëheqjen e përditshme të shkollës dhe i përgjigjet patronit dhe këshillit drejtues

Për çdo klasë ekziston kujdestar klase. Kujdestari i klasës i mëson nxënësit në të gjithë lëndët. Mund të ketë mësues plotësues në shkollë të cilët do t'i ndihmojnë kujdestarit të klasës. P.sh , fëmija juaj mund të ketë mësues për mësim plotësues të gjuhës angleze i cili do t'i ndihmojë në mësimin e asaj gjuhe. Personeli mund të jetë i gjinis mashkullore ose femërore. Të gjithë mësuesit në Irlandë janë të përgatitur profesionalisht ashtu që mendimet dhe këshillat e tyre në arsimimin e fëmijës tuaj duhet t'i ndëgjoni dhe respektoni.

11. Kush gjendet në këshillin drejtues?

Këshilli drejtues përbëhet nga përfaqësues të prindërve, mësuesve, mentorëve, patronave, drejtorëve dhe bashkësive. Qëllimi i këshillit drejtues është që të siguron punë efektive të shkollës dhe nxënësve tu mundësoj arsimim kualitativ.

B. Përcaktimet e veçanta

12. Çka nëse djali/vajza ime ka problem të caktuar?

Nëse fëmija ka problem me mësimin atëherë shkolla do ta vlersoj problemin. Mësuesi për përkrahje nëse ekziston i tillë në shkollë, do të punoj me fëmijën. Nëse është e nevojshme ndihmë e mëtutjeshme atëher do të kërkohet ndihmë nga psikologu i ministrisë për arsim dhe shkencë.

Kohë pas kohe fëmijët në shkollë i kontrollon ekip medicinal. Kontrollimi përmban kontrollimin e ndëgjimit, dhëmbëve dhe shiqimin e fëmijës. Është i mundshëm edhe vaksinimi. Shkolla paraprakisht do t'i informoj prindërit për kontrollimet e tilla dhe çka ato mbajnë në vete.

Nëse fëmija ka probleme shëndetsore p.sh me ndëgjim, folje ose trauma/rëndësi psikologjike, atëherë do të kërkohet ndihmë nga këshilli lokal për shëndetsi. Për tu pranuar ndihma nga specialistët mund të kaloj kohë e caktuar.

13. Çka me arsimimin parashkollorë?

Ekzistojnë numër i kufizuar i shteteve të cilët përmbajnë institucione të cilat janë në disponim. Në të vërtetë ekzistojnë vetëm 40 programe parashkollorë për fillim të hershëm të cilët janë në disponim në gjith vendin. Ekzistojnë edhe disa institucione private parashkollorë për të cilat duhet të pagohet shkollimi. Disa institucione janë subvencionare- pyetni shërbyesin për mirqenien e bashkësis a mund t'iu ndihmoj.

14. Por fëmija im din dobët anglisht?

Përvoja e deritanishme flet se të rinjtë shumë shpejtë mësojnë anglisht. Normal është që nxënësi i cili nuk është irlandez, edhe nëse ai/ajo dobët e din anglishten të vëhet në klasë me nxënësit e moshës së njejtë..

Vajza/djali juaj mund të ketë mësues për gjuhë i cili atij/asaj mund t'i ndihmojë në mësimin e anglishtes. Ministria për arsim dhe shkencë siguron program për gjuhë i cili do t'iu mundësoj shkollave që të sigurojnë orë të shkëlqyeshme të anglishtes për nxënësit të cilët nuk janë irlandez dhe të cilët kanë probleme me gjuhën angleze. Djali/vajza juaj do të marrë librezë për gjuhë e cila do ti ndihmoj në mësimin e anglishtes. Ju mund të ndjekni përparimin e tij/saj duke kontrolluar kohë pas kohe librezën.

15. Çka me librat shkollorë?

Nëse nuk jeni në gjendje ta paguani çmimin e plotë të librave shkollorë atëherë do ta pyetni drejtorin e shkollës a mund t'iu ndihmoj në gjetjen e librave. Ministria e arsimit dhe shkencës u sigurojnë shkollave subvencion vjetorë ashtu që ato të ndihmojnë tek disa harxhime në gjetjen e librave shkollorë.

16. Çka me udhëtimin deri në shkollë?

Në përgjithësi, nëse fëmija ka më pakë se 10 vjet dhe jeton më largë se dy milja (3km) larg shkollës, ai/ajo ka të drejtë në udhëtim pa pagesë me autobusin e shkollës. Nëse fëmija ka mbi 10 vjet dhe jeton më shumë se 3 milja (4.5 km) larg shkollës, ai/ajo ka të drejtë në udhëtim pa pages me autobusin e shkollës. Nëse u brengos diçka në lidhje me transportin shkollorë, bisedoni me drejtorin e shkollës.

C. Jeta mbrenda shkollës

17. Në çfar klase do të jetë i vendosur fëmija im?

Për këtë do të vendos drejtori i shkollës në marveshje me ju mundësisht edhe me kujdestarin e klasës. Vendosja në klasë zakonisht bazohet në moshën e fëmijës, mirëpo para syshë mund të meret edhe përvoja paraprake e arsimit. Sipas kësaj në bisedën tuaj të parë me drejtorin nga ju mund të kërkohen të dhëna për arsimimin e deritashëm të fëmijës suaj.

18. Çka do të mësoj fëmija im në shkollë fillore?

Plani mësimorë i shkollës fillore inicon rëndësin e zhvillimit të dashurisë ndaj mësimin te fëmija juaj e cila do ta ndjek tanë jetën. Shkolla duhet të jetë përjetim i këndshëm dhe i hareshëm.

Në planin mësimor të shkollës fillore ekzistojnë gjashtë drejtime kryesore.

Drejtimi mësimorë _____
Gjuha

Lëndët
Anglisht dhe gjuha irlandeze. Në disa shkolla mund të ofrohet
gjuha e huaj.

Matematika

Arsimim shoqëror, ekologjik dhe shkencor Histori, gjeografi, shkencë

Trajtim trupor

Arsimim shoqëror, personal dhe shëndetsor

Fëmijëve gjithashtu do t'iu ofrohet klasa me arsimim religjioz. Përderisa pritni vendimin për zgjidhjen e lutjes suaj për status të refugjatëve, fëmija juaj nuk është patjetër të ndjek arsimim irlandez ose religjioz, nëse ajo është dëshira juaj, por prej tij/saj mund të kërkohej që të mbetet në klasë nën mbikqyrjen e mësuesit. Rreth këtyre çështjeve duhet të bisedoni me drejtorin e shkollës.

19. Çka është etika shkollore?

Shkolla post-filllore irlandeze përparon tolerancën, respektin e dyanshëm dhe mirkuptimin kulturor etik, racor, shoqërorë dhe religjioz të ndryshimeve. Ajo gjithashtu përparon realitetin e ndryshimeve mes shoqëris interkulturore. Festimi i dallimeve interkulturore për shumë shkolla bëhet komponent e rëndësishme e jetës shkollore, ajo veçanërisht është e potencuar nëpërmes përvijës në programin qytetarë, shoqërorë dhe politik të arsimimit. Rastet për promovimin e arsimimit interkulturor rriten nëpërmjet programit mësimorë me studimin e gjeografisë, muzikës, historisë etj.

Shkolla është mjedis multikulturorë. Respektohet prejardhja etnike dhe religjioni i çdo fëmije. Pritet që çdo fëmij gjithashtu të respektoj fëmijët tjerë në shkollë.

Shkolla nuk do të toleroj asnjë sjellje kuptimkeqe e cila motivohet nga raca qoft nga fëmijët irlandez apo fëmijët të cilët nuk janë të nacionalitetit irlandez.

20. Si do të mësohet fëmija im?

Një mësues e mësonë klasën e vetë në të gjitha sferat e planit arsimorë dhe programeve. Për sferat speciale, p.sh orët e gjuhës angleze mund të punëohen mësues tjerë. Në disa shkolla më të vogla një mësues mund t'i mësoj më shumë lëndë në klasë të njëjtë. Fëmijët mësojnë nëpërmjet përvijës së lehtë dhe aktive. Me rëndësi është që fëmija juaj të shkojë në shkollë çdo ditë, përderisa nuk egzistonë ndonjë shkak i arsyeshëm për mosardhje. Lëshimi edhe i një dite shkollore mund të sjellë deri te ajo që fëmija të mos jetë në shkollë të njëjtë me nxënësit tjerë.

21. Si notohen nxënësit në arsimimin fillor?

Mësuesit në shkollën fillore pandërprerë notojnë nxënësit gjat 8 viteve të arsimimit fillorë të tyre. Nxënësit notohen sipas të gjitha aspekteve të përvijës shkollore të tyre. Nuk ekziston provim shtetërorë në fund të arsimimit fillorë. Testet zgjidhen kohë pas kohe, kurse shumica e nxënësve japin provime shkollore në fund të vitit shkollore.

Shkollat zakonisht sjellin një lajmërim për përparimin e nxënësit gjatë çdo viti shkollore

22. A takohen prindërit me mësuesit?

Shkolla zakonisht organizon takime prind/mësues. Në ato takime mund të shihni shembuj të punimeve të nxënësve dhe të bisedoni për përparimin e fëmijës suaj vet më kujdestarin e klasës. Për takimin prind/mësues do të merni informim nga shkolla. Mundohuni që të vini në atë takim.

Përderisa në ndërkohë, brengoseni për përparimin e fëmijës suaj, mereni vesht për takim me kujdestarin e klasës.

23. A do të pritët nga fëmija im që t'i kryej detyrat e shtëpisë?

Rregullat në lidhje me detyrat e shtëpisë ndryshojnë nga shkolla në shkollë. Nëse shkolla e fëmijës suaj ka rregull të dhënies të detyrave të shtëpisë, atëherë është me rëndësi që fëmijës suaj t'i ofroni hapsirë dhe guxim. Ku është e duhur, ofroni ndihmë. Gjithashtu është me rëndësi të ndani kohë për bisedë me fëmijën tuaj për ate çka çdo ditë punon në shkollë, dhe nëse mundet, lexoni me te pjesët kryesore të librave shkollore ashtu që përforconi ate që është mësuar në shkollë.

24. A do ta kuptoj shkolla kulturën time?

Shkollat bëhen sa më të vetëdishme me kulturat e ndryshme sepse në sistemin tonë shkollore paraqiten sa e më shumë kultura. Informacionet mund të meren në librezat e organizatave joqeveritare. Edhe ju gjithashtu si prind nga kulturë e ndryshme mund të jepni informacione pas hapave të prindërve tjerë ose nëpërmjet konsultimit me kujdestarin e klasës.

25. Çka të bëj nëse fëmija im ka problem?

Për problemin bisedoni me fëmijën tuaj. Ai mund të jetë problem me mësimin ose problem i natyrës personale ose shoqërore. Nëse problemin nuk mundeni ta zgjidhni në shtëpi atëher ndoshta duhet të bisedoni me kujdestarin e klasës. Përderisa problemi edhe më tej mbetet i pazgjidhur, ndoshta do të duhet të kontaktoni me drejtorin. Mund të merni me vete shok nëse u duhet ndihmë në kuptimin e gjuhës angleze.

26. Çka të bëj nëse fëmija im maltretohet?

Maltretimi fizik, këto keqtrajtime fizike dhe verbale nuk janë të pranueshme në shkollat e irlandës. Maltretimi ndonjëherë ndodh në shkollë bile edhe në rrugë deri në shkollë. Përderisa dikush sillt ashtu ndaj fëmijës tuaj ose djali juaj është i përfshirë në këtë lloj sjellje, atëherë kjo është punë serioze. Asnjë fëmijë nuk mundet të vuaj nga dora e keqbërësit.

Përderisa fëmija juaj është i maltretuar, **mos** merni pjesë me prindërit e fëmijës tjetër. **Bisedoni** me kujdestarin e klasës dhe drejtorin për ndodhitë dhe zgjidhni problemin në atë rrugë.

27. Çka me diciplinën në shkollë?

Mësuesit lavdrojnë fëmijët kur ato mundohen dhe mirë i zgjidhin detyrat shkollore dhe shtëpiake. Lëvdrimi ndihmon në motivimin e fëmijës.

Dënimi fizik nuk shfrytëzohet në shkollat e Irlandës. Ai është kundërligjorë. çdo shkollë ka rregulla të diciplinës. Masat të cilat i ndërmer ndonjë shkollë janë të renditura në rregulloren e sajë. Prindërve u jepet rregullore e diciplinës. P.sh, shkollat shpesh janë shumë rigorozë në rregullat e veshjes (uniforma shkollore dhe mbajtja e zbukurimeve), shkuarjen e rregullt, saktësinë dhe sjelljen. Përgjegjësia e prindërve është që të pranojnë rregulloren shkollore dhe të mundohen që fëmijët e tyre ta kuptojnë dhe sillen sipas saj.

Përgjegjësi është që të pranojnë rregulloren e shkollës dhe të kujdesen që djali/vajza e tyre ta kuptoj dhe sillen sipas saj. Përderisa ekziston problem dicipline ose ndonjë problem tjetër, prindërit duhet së pari të mundohen ta zgjidhin me djalin/vajzën e tyre dhe ku duhet edhe të bisedohet edhe me kujdestarin e klasës. Përderisa problemi vazhdon. Për zgjidhje bisedoni me drejtorin.

P.sh , nëse fëmija juaj pandërprerë i then rregullat, do t'iu informoj kujdestari i klasës ose drejtori i shkollës. Do të keni rast që me personelin e shkollës të bisedoni për pyetje të ndryshme. Nga ju do të pritet që të kujdeseni për përmisimin e sjelljes të fëmijës suaj.

Përderisa fëmija të themi seriozisht i ka thyer rregullat e shkollës, shkolla mundë, pasi që i ka provuar të gjitha opcionet e mundëshme, si metodë të fundit t'a suspendoj fëmija nga shkolla. Ai është vendim i rrallë dhe serioz. Për këtë suspendim prindërit do të njoftohen me shkrim. Prindi mund të ankohet te këshilli drejtues për suspendimin, mirëpo si metod e fundit e ankesës mund ti drejtohet ministrisë për arsim dhe shkencë.

28. A duhet nxënësi të mbaj uniformë shkollore?

Shumë shkolla kërkojnë nga nxënësit e tyre të mbajnë uniforma shkollore. Ndonjëher fëmijët duhet të mbajnë veshje speciale dhe mbathje sportive. Fëmijët në shkollë duhet të mbajnë veshje të rregullt. Veshja dhe flokët duhet të jenë të pastërta dhe të regulluara.

Atje ku është e nevojshme, për sigurim të veshmbathjes shkollore (ang. Back to School Clothing and Footwear Scheme) lajmroni te shërbyesi për mirqenijen e bashkësisë.

Nëse për shkak të kulturës keni problem që fëmija juaj të mbaj uniformë shkollore, me rëndësi është këtë pyetje ta diskutoni me drejtorin e shkollës

29. Çka më shumë u pengon drejtorëve dhe mësuesve?

1. Mosardhje të shpeshta në shkollë
2. Pengimi i nxënësve në klasë ose në teren sportiv
3. Shkuarja e familjeve nga vendi pa e informuar shkollën për ate
4. Mosmbajtja e uniformës shkollore
5. Mosrespektimi i qëndrimeve profesionale të drejtorit ose mësuesve të klasës
6. Moskryerja e detyrave të shtëpisë

D. Prindërit

30. Cili është roli i prindërve?

Kushtetuta e Irlandës potencon se prindërit janë edukatorët themelor të personave të rinjë. Përkrahja nga prindërit ka rëndësi të madhe te fëmija juaj gjatë viteve të shkollimit fillor.

Me rëndësi është që të tregoni interesim për ate që fëmija punon në shkollë. Lëvdroni punën e fëmijës tuaj në çdo rast. Përkrahja juaj ka rëndësi të madhe dhe do ta motivoj që të vazhdoj të mundohet.

Me rëndësi është që të konsultoheni me shkollën për përparimin e djalit/vajzës suaj. Nëse u brengos diçka në arsimimin e tyre, atëherë është me rëndësi të bisedoni me kujdestarin e klasës ashtu që fëmija juaj të fitoj arsimim më të mirë

31. Çka duhet të bëni nëse fëmija juaj patjetër të mungoj në shkollë për një apo më shumë ditë?

Sipas LIGJIT TË IRLANDËS është përgjegjasi dhe detyrë e juaj që shkollën ta informoni për mungesën e fëmijës tuaj në shkollë nga sëmundja ose rrethana tjera të veçanta. Duhet të shkoni në shkollë,ta thirni mësuesin e klasës ose ti dërgoni letër më arsyet e mungesës së djalit/vajzës suaj.

Në letrën tipike mund të shkruhet

(emri i fëmijës) ka munguar dje (data) nga shkolla për arsye të sëmurjes(ose ndonjë shkak tjetër) Nënskrim: (emri juaj)

Nëse ate nuk e bëni mësuesi i klasës dhe drejtori do të jenë të brengosur për mirqenijen e fëmijës suaj.

Nëse fëmija juaj mungon rregullisht ose më gjat kohë pa informimin e personave përkatës në shkollë, atëher juve si prindër do t'iu vizitoj shërbyesi për shkuarjen në shkollë. Mos informimi i shkollës për mos-shkuarjen e fëmijës, konsiderohet si gabim i vërtet i prindit.

32. Çka nëse ju dhe familja juaj zhvendoseni në rajon të ri më larg shkollës?

Me rëndësi është që ta informoni shkollën se fëmija juaj zhvendoset në lokacion të ri dhe se nuk do të kthehet në shkollë. Nga drejtori i shkollës duhet të kërkonte informim me shkrim për përparimin e deritashëm të fëmijës suaj, duke marrë para syshë hartën e gjuhës të personit të ri. Kur e regjistroni fëmijën tuaj në shkollë të re dhe rajon të ri, me rëndësi është që drejtorit të ri ti tregoni se fëmija juaj është i shkolluar në një shkollë tjetër irlandeze dhe drejtorit ti jepni fotokopije të dokumenteve nga shkolla e mëparshme. Drejtorët pastaj këmbëjnë informacione të rëndësishme për shkollimin e fëmijës suaj.

Përderisa shkolla ju ka dhënë libra shkollore dhe mjete tjera, me rëndësi është që t'ia ktheni shkollës para shkuarjes.

33. A takohen prindërit si bashkësi?

Shumica e shkollave kanë këshill të prindërve dhe të gjithë prindërit thiren dhe u krijohet vullnet për t'u antarsuar.

34. A mund unë të ndihmoj në shkollë?

Nëse doni të merni pjesë me punë vullnetare në shkollë, bisedoni më kujdestarin e klasës ose drejtorin. Puna e këtillë mund të jetë ndihmë në aktivitetet sportive, koncertet, kampet verore, bisedë për kulturën tuaj/muzikën vendin etj. Ekzistojnë shumë mundësi për të ndihmuar- vetëm tregoni drejtorit/kujdestarit se doni të merni pjesë në shkollë- si shumica e prindërve irlandez. Puna e tillë vullnetare shpesh organizohet në bashkpunim dhe nëpërmjet këshillit të prindërve.

Këshilla për prindër

Drejtimet e ardhshme mund të jenë përkrahje në arsimimin e fëmijës suaj dhe zhvillimin e tij në mënyrë të pjesërishme:

Shfrytëzoni gjuhën e parë (amtare) në shtëpi me fëmijët tuaj.

Bisedoni me fëmijët tuaj sa më shumë që është e mundur. Tregoni atyre për ditën tuaj dhe pyetni për ditën e tyre. Veçanërisht kuptoni çka i brengos.

Kujdeseni që fëmija juaj ti kryej të gjitha detyrat që i ka marrë nga mësuesi.

Për detyrat e shtëpis është e nevojshme përafërsisht:

10 deri 30 minuta për fëmijët 9 vjeçarë

30 deri 90 minuta për fëmijët në klasat fillore seniore
(9-12 vjet)

kuptoni çfar detyra zgjidh fëmija juaj dhe kontrolloni kur të jetë puna e gatshme.

Organizoni vend për fëmijën tuaj ku do ti kryej detyrat e shtëpisë dhe ku nuk do t'i pengoj televizori dhe zhurma.

Fëmijëve të ri loxoni dhe thuani që edhe ata tu lexojnë juve- offt në anglisht apo në gjuhën tuaj.

Ndihmoni njerëzit e rinjë t'i kuptojnë mundësit që ua ofron ardhmëria nëse mundohen të mësojnë.

Gjatë kohës së pushimeve shkollore

Ekziston mundësia që fëmija juaj gjat festave shkollore të haroj diçka nga gjuha e mësuar angleze. Me rëndësi është që, fëmijët të shfrytëzojnë, lexojnë ose ndëgjojnë diçka nga gjuha angleze çdo ditë. Ju lutemi të mundoheni të gjeni rast që fëmija juaj ta shfrytëzoj gjuhën angleze.

Për shembull, ai/ajo :

Mund të ndjek program televiziv dhe t'iu tregoj juve për atë;

Mund që fëmija juaj t'iu lexoj libër me zë;

Mund në shitore të kërkoj ndonjë artikull etj.

Mund çdo ditë gjatë festës ta shiqoj ditarin me fotografi dhe tekst të shkruar.

Përveçse është me rëndësi që fëmija juaj ta mësoj anglishten, gjithashtu është shumë më rëndësi që ai/ajo mos të harojë gjuhën amtare familjare. Shfrytëzoni çdo rast për shfrytëzimin e gjuhës tuaj amtare me fëmijën tuaj dhe flisni atij/asaj për atdheun tuaj. Mund të shkoni në librarin e vendit të hyni në internet dhe të kuptoni çka ndodh në atdheun tuaj.